



Mbështetur në nenin 40.2 nën b) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040, Të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal, Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi, si dhe nenit 40.2 nën pikën 2 të Statutit të Komunës së Klinës, Rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa, të datës 10.09.2018 dhe Debatit me Publikun, më datën 18.09.2018, Kuvendi i Komunës së Klinës në seancën e VIII-të të rregullt për vitin 2018, të mbajtur, më 21.09.2018 dhe vazhdimin e seancës, më datën 25.09.2018, mori këtë:

V E N D I M

Miratohet Buxheti i Komunës së Klinës dhe Projektet me prioritet për vitin 2019

I

Miratohet buxheti i Komunës së Klinës dhe Projektet me prioritet për vitin 2019.

II

Buxheti si në pikën 1 (një) të këtij Vendimi përfshin shumën totale prej 10,138,948.00€.

Kategoritë buxhetore		2019	2020	2021
1	Paga dhe mëditje	6,042,572.00	6,042,572.00	6,042,572.00
2	Mallra dhe shërbime	1,070,934.00	1,070,934.00	1,070,934.00
3	Komunalit	180,000.00	180,000.00	180,000.00
4	Transfere dhe sub.	105,000.00	105,000.00	135,213.00
5	Kapitale	2,740,442.00	3,049,566.00	3,389,515.00
TOTALI :		10,138,948.00	10,448,072.00	10,818,234.00

III

Buxheti si në pikën 2 (dy) të këtij Vendimi dhe lista e projekteve me prioritet për vitin 2019, miratohet me keto ndryshime:

1. Në kuadër të Kategorisë së Kapitaleve bëhen këto ndryshime:

Në Projektin, Bashkëfinancim me donator, është zvogëluar vlera prej 490,442.00€ në 400,442.00€.

Ky ndryshim prej 90,000.00€ është transferuar në Projektin: Asfaltimi i rrugëve dhe trotuarëve në qytet dhe periferi 155,000.00€ dhe është bërë 245,000.00€.

2. Në Kategorinë e Mallrave dhe Shërbimeve bëhen këto ndryshime:

Vlera prej 5000.00€ të ndahet si kategori e veçantë buxhetore për Buxhet gjinor.

IV

Vendimi është i plotëfuqishëm me miratim në Kuvendin e Komunës, 15 ditë pas protokollimit në MAPL dhe 7 ditë pas publikimit në faqën zyrtare të Komunës.

Me këtë Vendim njoftohen: MAPL, MF, Kryetari i Komunës, Drejtoria e FEZH, Zyra për Informim, Shërbimi për Punë të Kuvendit dhe një për Arkivin e Komunës së Klinës.

KUVENDI I KOMUNËS KLINË

01Nr. 06-6320 2018
Klinë, më 27.09 2018



Kryesuesi,
Fadil Gashi